



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.123

7 shtator

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.724, datë 1.9.2010

Për disa ndryshime në vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të
Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për
zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar.....

6553

VENDIM
Nr.724, datë 1.9.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZBATIMIN E KODIT
RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

1. Pika 1 e nenit 246 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Vendet ku vendosen targat e regjistrimit, të provës dhe të njohjes duhet të paraqesin një sipërfaqe plane ose pothuajse plan, me gjerësi të përshtatshme për të mbajtur targën. Përmasat e tipave të ndryshme të targave janë si më poshtë:

a) Shenja e identifikimit për ciklomotorët:

- formati 130 x 115 mm, figura III.3/1.

b) Targat e regjistrimit për motomjetet:

- formati 212 x 205 mm, figura III.3.

c) Targat e regjistrimit të mjeteve të tjera me motor dhe për rimorkiot, përjashtoj ato të pikës “a” dhe “b”:

- formati 520 x 112 mm, figura III.4/1;

- formati 264 x 205 mm, figura III.4/2.”.

2. Pika 1 e nenit 248 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Targat e mjeteve, që i bashkëlidhen këtij vendimi:

a) Targat e mjeteve rrugore vetëlëvizëse, buxhetore dhe private: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të zeza (figurat III.4/1.a, III.4/2.a dhe III.3/a);

b) Targat e mjeteve rrugore në shërbimin taksi: sfondi i verdhë, shkronjat dhe numrat të kuq shenja dalluese T (taksi), (figurat III.4/1.b dhe III.4/2.b);

c) Targat e mjeteve rrugore të përkohshme: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të kuq, shenja dalluese PRK (përkohshme), (figurat III.4/1.c, III.4/2.c dhe III.3/c);

ç) Targat e mjeteve rrugore të trupit diplomatik: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të gjelbër, shenja dalluese CD (trup diplomatik), (figurat III.4/1.d, III.4/2.d dhe III.3/d);

d) Targat e mjeteve rrugore të shërbimit të trupit diplomatik: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të gjelbër, shenja dalluese TR (figurat III.4/1.e, III.4/2.e dhe III.3/e);

dh) Targat e mjeteve rrugore të policisë: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat blu, shenja dalluese MB (Ministria e Brendshme), (figurat III.4/1.ë, III.4/2.ë dhe III.3/ë);

e) Targat e mjeteve rrugore në provë: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të kuq, shenja dalluese PROV, (figurat III.4/1.f, III.4/2.f dhe III.3/f);

ë) Targat përsëritëse: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të kuq (figurat III.4/1.g, III.4/2.g dhe III.3/g);

f) Targat e makinave bujqësore: sfondi i gjelbër, shkronjat dhe numrat të bardhë, shenja dalluese MB (makinë bujqësore), (figurat III.4/1.h dhe III.4/2.h);

g) Targat e makinave teknologjike: sfondi i gjelbër, shkronjat dhe numrat të bardhë, shenja dalluese MT (makinë teknologjike), (figurat III.4/1.i dhe III.4/2.i);

gj) Targat e rimorkiove, buxhetore dhe private: sfondi i gjelbër, shkronjat dhe numrat të bardhë, shenja dalluese R (rimorkio), (figurat III.4/1.j dhe III.4/2.j);

h) Targat e rimorkiove bujqësore: sfondi i gjelbër, shkronjat dhe numrat të bardhë, shenja dalluese RB (rimorkio bujqësore), (figurat III.4/1.k dhe III.4/2.k);

i) Targat e rimorkiove teknologjike: sfondi i gjelbër, shkronjat dhe numrat të bardhë, shenja dalluese RT (rimorkio teknologjike), (figurat III.4/1.l dhe III.4/2.l).”.

3. Neni 250 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 250

Stema zyrtare (emblema), të cilën duhet të mbajnë në të majtë targat e çdo tipi, paraqet sfondin me ngjyrën e flamurit të BE-së, blu, mbi të cilën vendoset shqiponja dhe simboli A1 me ngjyrë të bardhë. Në të djathtë të targës, opsionale, sfondi me ngjyrën e flamurit të BE-së, blu, mbi të cilën vendoset viti i parë i regjistrimit në Republikën e Shqipërisë (brenda një rrethi të bardhë) dhe shenja e ndarjes administrative me ngjyrë të bardhë.”.

4. Pika 1 e shtojcës X ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kriteret për krijimin e të dhënave janë:

a) Targa e mjeteve rrugore vetëlëvizëse (e përparme dhe e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, tre karaktere numerike dhe dy karaktere alfabetike, (figurat III.4/1.a dhe III.4/2.a);

b) Targa e mjeteve rrugore të shërbimit taksi (e përparme dhe e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, tri karaktere numerike dhe karakterin alfabetik “T” (figurat III.4/1.a dhe III.4/2.b);

c) Targa e motomjeteve (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike dhe tri karaktere numerike (figura III.3/a);

ç) Targa provë e mjeteve rrugore, rimorkiove, makinave bujqësore dhe teknologjike (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, një karakter numerik dhe katër karaktere alfabetike “PROV” (figurat III.4/1.f dhe III.4/2.f);

d) Targa provë e motomjeteve (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, një karakter alfabetik, një karakter numerik dhe katër karaktere alfabetike “PROV” (figura III.3/f);

dh) Targa e përkohshme e mjeteve rrugore, rimorkiove, makinave bujqësore dhe teknologjike (e pasme), mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, një karakter numerik dhe tri karaktere alfabetike “PRK” (figurat III.4/1.c dhe III.4/2.c);

e) Targa e përkohshme për motomjetet, (e pasme), mban, sipas radhës, emblemën, një karakter alfabetik, një karakter numerik dhe tri karaktere alfabetike “PRK” (figura III.3/c);

ë) Targa e mjeteve rrugore të trupit diplomatik (e përparme dhe e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “CD”, katër karaktere numerike dhe një karakter alfabetik (figurat III.4/1.d dhe III.4/2.d). Targa e motomjeteve të trupit diplomatik (e pasme) mban sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “CD”, dy karaktere numerike dhe dy karaktere alfabetike (figura III.3/d);

f) Targa e mjeteve rrugore të shërbimit të trupit diplomatik, (e përparme dhe e pasme), mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “TR”, katër karaktere numerike dhe një karakter alfabetik (figurat III.4/1.e dhe III.4/2.e). Targa e motomjeteve të shërbimit të trupit diplomatik (e pasme) mban sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “TR”, dy karaktere numerike dhe dy karaktere alfabetike (figura III.3/e);

g) Targa e makinave bujqësore (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, dy karaktere alfabetike “MB”, dhe dy karaktere numerike (figurat III.4/1.h dhe III.4/2.h);

gj) Targa e makinave teknologjike (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, dy karaktere alfabetike “MT” dhe dy karaktere numerike (figurat III.4/1.i dhe III.4/2.i);

h) Targa e rimorkiove (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, një karakter alfabetik “R” dhe tri karaktere numerike (figurat III.4/1.j dhe III.4/2.j);

i) Targa e rimorkiove bujqësore (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, dy karaktere alfabetike “RB” dhe dy karaktere numerike (figurat III.4/1.k dhe III.4/2.k);

j) Targa e rimorkiove teknologjike (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike, dy karaktere alfabetike “RT” dhe dy karaktere numerike (figurat III.4/1.l dhe III.4/2.l);

k) Targa e mjeteve rrugore të policisë (e përparme dhe e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “MB”, tri karaktere numerike dhe dy karaktere alfabetike (figurat III.4/1.ë dhe III.4/2.ë);

l) Targa e motomjeteve të policisë (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “MB”, dy karaktere numerike dhe një karakter alfabetik (figura III.3/ë).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Figura III.4/1.a, neni 248



Figura III.4/2.a, neni 248



Figura III.3/a, neni 248




Figura III.4/1.b, neni 248



Figura III.4/2.b, neni 248




Figura III.4/2.c, neni 248




Figura III.3/c, neni 248

Figura III.4/1.d, neni 248



Figura III.4/2.d, neni 248



Figura III.3/d, neni 248




Figura III.4/1.e, neni 248




Figura III.4/2.e, neni 248



Figura III.3/e, neni 248

Figura III.4/1.ë, neni 248



Figura III.4/2.ē, neni 248



Figura III.3/ē, neni 248

Figura III.4/1.f, neni 248



Figura III.4/2.f, neni 248




Figura III.3/f, neni 248

Figura III.4/1.g, neni 248




Figura III.4/2.g, neni 248




Figura III.4/1.h, neni 248




Figura III.4/2.h, neni 248




Figura III.4/2.i, neni 248

Figura III.4/1.j, neni 248





Figura III.4/1.k, neni 248






Figura III.4/1.1, neni 248




Figura III.4/2.1, neni 248



Figura III.3/1, neni 246

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.9.2010

Doli nga shtypi më 7.9.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë